

Diaspora

Zvicër: Tel. +41 (0) 79 705 19 00 · E-Mail: diaspora@zerionline.info

Gjermani: Tel. +49 (0) 7331 30 18 19 · Fax: +49 (0) 7331 30 18 96 · E-mail: diaspora@zeridites.de

di@-logu

Çfarë presim nga diplomatët tanë?

Kosova së shpejti do t'i ketë përfaqësitë e saj diplomatike në disa vende të botës. Në mesin e tyre, edhe në vendet e Evropës Perëndimore, ku numri i shqiptarëve është mjaft i madh, si në Gjermani, Zvicër, Itali, Belgjikë, Austri etj. Çka presin bashkatdhetarët tanë nga përfaqësitë diplomatike të Kosovës dhe çfarë prioriteteve do t'u rekomandonin ata diplomatëve kosovarë, për punën që i pret në raport me mërgatën tonë në këto vende. Për këto mund të na shkruani në adresën e përhershme:

diaspora@zerionline.info

www.zeridites.de

Me: Albulena Kajtazi, producente e muzikës, Gjermani

Lena: Identifikohem me atë që bëj

Pavarësisht se shumë prej jush nuk mund të keni lexuar të shkruhet shpesh për Albulena Kajtazi, producente shqiptare nga Prishtina që në moshën e fëmijërisë ka "futur këmbën" në botën e muzikës. Albulena është e lindur në Prishtinë ndërsa fëmijërinë e kaloi në Gjermani. Albulena flet për jetën e saj, pasionin e muzikës dhe çështje të tjera...

Intervistoi: Elife Kurteshi

Zëri i ditës: Ju njohim më shumë me emrin artistik lena'z beat. Jeni njëra ndër producentet e rralla shqiptare... Fillimisht për ata që nuk dinë shumë për ju dhe që nuk u ka rastisur të lexojnë ende diç për ju do të mund të na bënit një prezantim tuajin: prej nga jeni, ku jetoni, cila është familja juaj etj. ?

Albulena Kajtazi: Pra, unë jam Albulena Kajtazi, jam e lindur në Prishtinë dhe që nga viti 1995 jetoj në Gjermani. Atëbotë, edhe me fatin tonë dhe të familjes, luajti jeta, dhe u detyruam që të emigrojmë në Gjermani. Isha në përfundim të klasës së dytë të shkollës fillore kur jam ndarë nga shokët, shoqet dhe mësuesja ime e shkollës "Ismail Qemajli" në Prishtinë... Pra, rrita ime dhe zhvillimi im kanë vazhduar këtu në Gjermani, ku pastaj kam kryer gjimnazin për ekonomi dhe kam zgjeruar njohuritë dhe mësimet për biznesin muzikor dhe teknologjinë informative.

Zëri i ditës: Kur ju lindi pasioni për muzikën?

Albulena Kajtazi: Jam rritur e zhvilluar në një familje ku është kutivuar dashuria ndaj artit, kulturës e në këtë mes edhe të artit muzikor. Me kohë e kam kuptuar se talentet e mia i kam trashëguar edhe nga prirjet e prindërve të mi që kanë një ndjenjë të kultivuar edhe për muzikën. Fillimisht dëshira e vëlait tim, Ardianit, që të merret me muzikën e trendit të ri, ndikoi që edhe unë dhe pastaj edhe motra ime (e njohur me emrin Gjira), pra, së bashku krijuam një ambient të ngruhtë muzikor. Kishim një kitarë në shtëpi, një kibord (piano elektrike), çiftelinë, defin dhe këto instrumente sikur nxisnin e sfidonin që t'i sprovonim talentet tona...

Zëri i ditës: A mund të na shkëputësh ndonjë detaj nga fillimet tuaja më serioze në muzikë?

Albulena Kajtazi: Mendoj se që nga momenti kur më është shfaqur dëshira që të mësoj dhe zgjeroj njohuritë e mia me të gjitha gjërat që lidhen me krijimin, realizimin dhe shitjen e muzikës, më është rritur



Albulena Kajtazi

edhe më shumë dashuria që të sprovoj veten në këto drejtime. Komponimin dhe produktionet e muzikes në fillim i kam mësuar në mënyrën "Learning by doing". Jam mbyllur në dhomë dhe kam bërë tërë ditën muzikë!... Vetëm pas disa vitesh e kam kuptuar se këtë mund ta bëj edhe profesion timin... Dhe fillova ta ushqej trurin edhe me informacione të tjera rreth muzikës, teknologjinë informative muzikore, (programet e ndryshme kompjuterike), ligjet e shitjes, të drejtat e autorit etj.

Zëri i ditës: Çfarë zhanri muzikor zakonisht preferoni të kultivoni në kompozimet tuaja? Jeni në rrjedhë të asaj që po ndodhë në Kosovë?

Albulena Kajtazi: Shumicën i kam në zhanrin Pop/Rnb por edhe HipHop. Por, kam qejf që edhe të eksperimentoj, si tash së fundi në

një Mix të ri të këngës "Pop Champaign" ku kam provuar stilet Electro House, të cilën e kam bërë në bashkëpunim me Matrixx&Dappa Don nga SHBA. Me mundësitë e shumta të gërshetimeve, muzika sot do të thojë se nuk ka kufij dhe ndonjë ndarje shumë e skajshme në ndonjë lloj a zhanër do të më dukej artificiale! Pra, shumë

çka varet nga ndjenja, e cila është më e rëndësishme se sa ndonjë shablon i ndonjë zhanri... Ndërsa, për atë që po ndodhë në Kosovë herë herë mendohej që të jem në rrjedhë që të kem së paku një informacion të përgjithshëm, dhe mund të them se ka larmani dhe ka përpjekje që të kultivohen thuaja të gjitha rrymimet që aktualisht po ndodhin në botën e muzikës bashkëkohore, por hetohen edhe ndikime, për të mos thënë thjeshtë imitime, që shpesh e dëmtojnë arritjen e kreativitetit origjinal... krijimin e një karakteri origjinal.

Zëri i ditës: Gjithsesi se suksesi juaj lidhet edhe me zgjerimin e bashkëpunimit krijues profesional?

Albulena Kajtazi: Unë vërtet kam krijuar një mori kontaktesh bashkëpunimi në Gjermani dhe punoj që në tregun gjerman të plasojmë artistët që i kemi në katalog. Krahas kësaj kam disa kontakte e bashkëpunime të them edhe internacionale si ai me "Flo Rida - Low Oriental Mix" Jay Sean - Rid It dhe ai me Sony BMG Music...

Zëri i ditës: Çfarë është kënga për ju?

Albulena Kajtazi: Kënga për mua është si një ventil për zbrastje për situata të ndryshme jetësore. Pikënisja mund të them se është ndjenja ime për momente të ndryshme jetësore. Mbi këtë përvojë përpiqem që të kompozoj dhe të shkru-

aj këngë të qëlluara, me të cilat, në radhë të parë identifikohem unë e pastaj edhe publiku.

Zëri i ditës: Në muzikën tuaj shpesh hetohen edhe ritme e tinguj e ngjyime emocionale të muzikës shqiptare, madje edhe me çifteli. Pse e bëni këtë, doni të përcillni një mesazh të veçantë?

Albulena Kajtazi: Mendoj se ajo që thash më sipër, se atmosfera e krijuar në familje ku ziejnë vlera të ndryshme kulturore e artistike të artit tonë shqiptar, pra edhe muzika të them folklorike, pra folklori ynë i begatë muzikor, pra edhe ritmi i instrumenteve tona popullore, dautllja, çiftelia etj. ndonjë vijë melodike, që përdor herë herë, i japin një ngjyrim më origjinal këngëve të komponuara. Ato gërshetohen natyrisht në stilin RNB ose House. Thjeshtë, është identiteti im, i cili shfaqet automatikisht... Mesazhi është: Made in Kosova !...

Zëri i ditës: Punën tuaj si producente muzikore e keni të dorës së parë, apo punoni edhe në ndonjë profesion tjetër?

Albulena Kajtazi: Në aspektin e kënaqësisë sime shpirtërore muzika është e dorës së parë, por është normale se duhet bërë edhe punë të tjera që të arrihet diç më shumë në jetë!... Aktualisht, krahas muzikës punoj në Munih për BMW / Informations Technology. Merrem me projekte në degën IT. Shumë të rinj sot ndodhë ta humbin udhën për ta gjetur vetveten, duke parë vetëm ëndrra me sy çelë për të arritur diçka!... Por, ato nuk arrihen pa një punë të madhe dhe shpesh edhe të shumanshme. Unë kam disa projekte ambicioze që kërkojnë punë dhe investim, e ato fillimisht duhet nisur e përballuar edhe vetë. Duhet investuar edhe vetë, siç duhet mësuar e studiuar shumë, dhe kjo është më parësore, sepse kjo është baza që më krijon mundësi t'i përkushtohem muzikës, pra kjo më krijon parakushte që unë t'i realizoj dëshirat e mia në këtë fushë.

Zëri i ditës: Në vitin 2008 ke fituar një çmim nga firma "1stthere-wathe BEAT" "New Comer Germany". Jeni votuar nga publiku për vendin e 2. Si e ke ndjerë veten në

këtë rast?

Albulena Kajtazi: Keq, sepse s'kam qenë e para!?! Ha,ha,ha!... Jo, gjithmonë njeriu ndjehet mirë kur e di që ke marrë një vlerësim pozitiv nga publiku! Në fund të këtij viti del një DVD në tregun gjerman, me kompozimet e producentëve më të njohur gjermanë, dhe të jeshë e prezantuar në mesin e tyre, dhe e nderuar me një çmim, është e natyrishtme të ndjehesh mirë, krenare madje, sepse është një vërtetim i nivelit të punës sime...

Zëri i ditës: Ka kohë që bashkëpunoni edhe me Martelli nga Bozz Music. A mund të na tregoni se si nisi e si është krijuar ky bashkëpunim?

Albulena Kajtazi: Po, Martelli më ka kontaktuar dhe më ftoi në studion e tij. Pas disa bisedash dhe dëgjimit të rreth i 150 komponimeve të mia, të cilat i dëgjua edhe së bashku, nisëm të planifikojmë edhe modalitetet e bashkëpunimit tonë të ndërsjellë profesional. Kam një ndjenjë të veçantë nga bashkëpunimi që kemi nisur tashmë, sepse të kesh mundësinë që të bashkëpunosh me njërin ndër producentët më të njohur në Gjermani është edhe një nder dhe vlerësim pozitiv i kualiteteve të punëve të mia që vijnë nga një producent, suksesi i të cilit flet vet kur kompozimet e tij interpretohen nga Xavier Naidoo, Azad, Kool Savas, Bushido etj. Gjithashtu më pëlqen ky bashkëpunim frytdhënës edhe në aspektin profesional muzikor por edhe në atë të menaxhimit dhe biznesit muzikor.

Zëri i ditës: Je e mirëpritur, si shqiptare, në këtë "biznes" ?

Albulena Kajtazi: Muzika e ka një të mirë sepse në vete ka një gjuhë universale , e cila bën që edhe të komunikosh më lehtë dhe të pëlqehesh, nëse ke vlerë. Kështu, identiteti nacional vetvetiu nuk luan ndonjë rol të madh...

Zëri i ditës: Ku mund të dëgjohet muzikën tuaj dhe të marrim informata të reja rreth projekteve dhe të arriturave tuaja?

Albulena Kajtazi: Atë keni mundësi ta bëni përherë nëse e hapni dhe dëgjoni Myspace në adresën: www.myspace.com/lenazbeat .

Informatori

AMBASADAT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË EVROPË

AUSTRI
Prinz Eugen Str. 18/1/5 · 1140 Wien
Tel. +43 1 328 8656 · Fax: +43 1 328 8658

BELGJIKË
30, Rue Tenbosch · 1000 Bruxelles
Tel. +32 2 640 3544 · Fax: +32 2 640 31 77

BRITANI E MADHE
24 Buckingham Gate · London SW1E 6LB
Tel. +44 20 7828 8897 · Fax: +44 20 7828 8869

DANIMARKË
NY Ostergade 7-1101 København K. Copenhagen
Tel. +45 3391 7070 · Fax: +45 3391 7969

FRANCË
57, Avenue Marceau · 75116 Paris
Tel. +33 1 47233100 · Fax: +33 1 47235985

GJERMANI
Friedrichstrasse 231 · 10969 Berlin
Tel. +49 30 259 3040 · Fax: +49 30 259 318 90

HOLANDË
Anna Paulownastraat 9b · 2518 BD Hague
Tel. +31 70 427 2101 · Fax: +31 70 427 2083

ITALI
Via Asmara 5 · 00199 Roma
Tel. +39 06 86224120 · Fax: +39 06 86216005

ITALI - Konsulata në Milano
Piazza Duomo, 17 C.A.P. 20127 Milano (Mi)
Tel. +39 02 86995396 · Fax: +39 02 86995396

KROACI
Jurisceva 2 A, II kat. · 10000 Zagreb
Tel. +385 1 4810679 · Fax: +385 1 4810682

MAQEDONI
Hristian Todorovski, Karposh 94/A · 1000 Shkup
Tel. +389 2 614636 · Fax: 389 2 614200

SPANJË
C/Maria de Molina 64-5 B · 28006 Madrid
Tel. +34 91 561 21 18 · Fax: +34 91 561 3775

SUEDI
Caplavägen 7 · 181 32 Lidingö, Stockholm
Tel. +46 8 7310920/30 · Fax: +46 8 767 6557

SHBA
2100 Street N.W. · Washington DC 20008
Tel. +1202 2234942 · Fax: +1202 6287342

ZVICËR - Ambasada e Republikës së Shqipërisë
Pourtallesstrasse 45 A 3074 Muri B. Bern Tel. +41 31 9526010
Fax. +41 31 9526012 e-mail: embassy.bern@mfa.gov.al

TURQI - Konsulata në Stamboll
Gümüşsuyu İnönü Cad. No. 30/6, Taksim, Istanbul
Tel. +90 212 244 32 56 · Fax: +90 212 2962427